

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

17.10.2024

Ora 11:00

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 13, datë 11.10.2024 të depozituar nga zoti Astrit Fadil Kaziu”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, , z. Elvis Çefa, z. Ilir Rusmali, z. Koli Bele, z. L. Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. J. Duni, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Z. Astrit Kaziu (ankuesi)

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore me nr. 13, të paraqitur nga zoti Astrit Kaziu, i cili është anëtar i listës shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Peqin. Objekti i ankesës së zotit Kaziu është “Kundërshtimi i vendimit nr. 181, datë 8.10.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për plotësimin e vakancës së krijuar në Këshillin e Bashkisë Peqin...”, nga mandati i ndërprerë i këshilltarit, nga zonja Tabaku, me zonjën Donika Ded Karina, e cila në listën shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, mban numrin rendor 13. Në seancën paraprake të zhvilluar para dy ditëve, vendosëm kalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore. Verifikojmë fillimisht prezencën. Është prezent trupa e KAS-it. Është prezent ankimuesi zoti Kaziu. Është prezent përfaqësuesi i KQZ-së në këtë procedim administrativ. Më rezulton që kanë dijeni, por nuk janë paraqitur personi i interesuar,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

zonja Donika Ded Karina, si dhe subjekti zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë. Staf i ma konfirmon këtë? Staf i konfirmon, kështu që në këto kushte ne nuk kemi pengesë për të vijuar me procedimin administrativ. I japim fillimisht fjalën ankuesit, për të parashtruar në mënyrë të përmbledhur, argumentat e tij për kundërshtimin e vendimit të Komisionerit. Atëherë zoti Kaziu, fjalën e keni ju!

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Sa për dijeni, jo për mungesë modestie, por unë kam qenë kandidat për deputet i Partisë Socialiste. Nuk pranova, unë nuk jam e nuk kam qenë anëtar partie, por i betuar socialist. Servet Pëllumbi me Gramoz Ruçin ma kanë kërkuar, por nuk kam pranuar. Nuk dua sepse nuk doja të hiqja shokët siç më hoqën mua si drejtor elektrik, apo drejtor shkolle, dmth ika. Pse e dua këtë? Kryetari i veteranëve të Peqinit ka marrë kryetarin e bashkisë dhe i ka thënë që “Astrit Kaziu që na ka ndihmuar kaq shumë, ka bërë libra e gjëra të tjera e dua ndër të parët, jo i dhjeti?”. Iku nr. 6 a 7 një femër, kaluan 10, futën të 11. Edhe kjo që iku tani, futën të 13, kjo që është tani. As e njoh e as më njeh! Përse dua tani?! Kam një arësye. Unë kam një në fis Mustafa Gjinishin dhe kam bërë një libër “Legjenda Gjinishi” këta tani kanë si asnjë në Shqipëri, kanë nga tre presidentë, dëshmorë, qytetarë nderi, nga komiteti i veteranëve dhe flenë gjumë. Ç’dua të bëj? Atje s’ka asnjë emërim, asnjë emërim shkolle... e kishim një që kishte mbaruar Shkollën “Harry Fultz”, më shtatë gjuhë të huaja, kur vjen puna Peqini im që luan mendsh pa Mustafa Gjinishit... më thoni çfarë duhet të bëj? Përderisa shokët më përkrahin, dua që të bëj një emërim të Mustafë Gjinishit..., shkolle. E dyta, të marr deputetin që të mos e le të flerë gjumë, të marr edhe kryetarin e bashkisë e të shkojmë në ambasadën angleze se të bëjmë binjakëzimin e një qyteti të Anglisë me Peqinin tim, që të mos mbetet ashtu siç është. Pra, më shumë po e bëj për këtë, ndaj e dua këtë punë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. E. Çefa: Faleminderit! Zoti Kaziu, ky komision nuk i ve aspak në dyshim qëllimet e mira tuajat për të qenë anëtar. Por, ajo që ne na intereson për efekt të procedimit administrativ është argumentimi përse ligjërisht ky mandat ju takon ju dhe jo personit që është mandatuar me vendimin që ju qnkimoni? Pra, ju lutem përqëndrohuni këtu që t'i kursejmë edhe kohën njëri tjetrit.

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Unë kam studjuar për fizikë, nuk jam jurist, megjithatë një shok më tha që i thuaj për shkeljen të ligjit.., të gjinisë me një fjalë.

Z. E. Çefa: Ju keni cituar nenin 164 të Kodit Zgjedhor, në ankimin tuaj dhe i qëndroni këtij argumenti?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Po!

Z. E. Çefa: Ju thoni që nuk ka asnjë arsye që detyrimisht të përzgjidhet një femër, sepse nuk jemi në kushtet që Kodi Zgjedhor kërkon dhe duhet normalisht të respektohet radha numërore, po themi, e zgjedhjes së anëtarit të këshillit bashkiak?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Po, atë kam thënë!

Z. E. Çefa: E qartë! A keni qenë prezent në vendimmarrjen e Komisionerit për këtë vendim, sepse KAS-i në vlerësimin paraprak të një kërkesë që ju kishit bërë më parë, ka vendosur moskalimin e asaj kërkesë në seancë për shqyrtimin në themel. Ajo kërkesë nuk kishte objekt ankimimi, por kemi rekomanduar Komisionerin që ju të jeni prezent dhe t'ia parashtroni atij gjatë vendimmarrjes këto argumenta.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Absolutisht jo!

Z. E. Çefa: Nuk keni qenë?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Absolutisht jo!

Z. E. Çefa: A keni pas dijeni?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Absolutisht jo!

Z. E. Çefa: Po ju keni shkruar në ankesë se ju kanë njoftuar për pjesëmarrjen, duke ju thënë dhe orën 12:00 që të vini të paraqiteni në KQZ?! Pra, dhe njëherë! Komisioneri ju ka njoftuar për të qenë prezent në mbledhje kur të shqyrtohej dhënia e mandatit e zonjës Karina?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Po, erdha këtu! Një ditë më parë u bë greva dhe thashë mos ka ndodhur ndonjë dëmtim e do të anullohej kjo. Kur erdha më takoi sekretaria e administratës dhe më tha që “ne e mbaruam atë punë”. Pse nuk do të bëhet në 12:30? “Jo, jo e mbaruam atë punë”.

Z. E. Çefa: Pra keni ardhur në KQZ, por nuk keni qenë prezent në mbledhje me Komisionerin?!

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Kjo shoqja duhet të ketë qenë!

Z. E. Çefa: Edhe një herë ju lutem, me emra se kjo shoqja...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Nuk ia di emrin, prandaj.

Z. E. Çefa: Pra keni takuar një person?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Po!

Z. E. Çefa: Na sqaroni pak për këtë!


Znj. P. Doçaj: E kemi njoftuar personin, nëpërmjet kontaktit telefonik, pasi numrin e gjetëm nëpërmjet subjektit zgjedhor që e ka propozuar si kandidat në listën shumëmemërore. E kam njoftuar unë personalisht zotërinë. I kam treguar orarin dhe adresën e saktë se ku do të paraqitej. Më ka kërkuar në momentin kur është paraqitur që të kontaktojë me mua. E kam sqaruar dhe njëherë se përse është ky projektvendim dhe çfarë do të përmbajë dhe mbledhja është në këtë orë. Duke qenë se u irritua pak sa në lidhje me sqarimin që unë i bëra dhe tha “nuk më intereson më” dhe u largua. Pra, nuk ka marrë pjesë në mbledhje për shkak ...

Z. E. Çefa: E qartë, e qartë!

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Çfarë, çfarë? Ju thatë “e mbaruam atë punë që më përpara”. Thashë “si e mbaruat, unë tani po vij?”

Z. E. Çefa: Dakord, nuk ka rëndësi! Rëndësi ka që ju nuk keni qenë prezent! Përfaqësuesi i KQZ-së, ju lutem për vendimin e Komisionerit dhe për ankimin, çfarë pretendimesh keni?


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Znj. M. Çelmeta: Të nderuar anëtarë të KAS-it!! Në datë 22.07.2024, Këshilli i Bashkisë Peqin, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Anxhela Shkëlqim Tabaku, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Peqin, të cilës i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 13, zonja Donika Ded Karina. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Peqin zonjës Donika Ded Karina, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, të cilës i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant. Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zonjës Donika Ded Karina, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për zonjën Donika Ded Karina. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zonjën Donika Ded Karina, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zonjën Donika Ded Karina, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zonja Donika Ded Karina, në Këshillin e Bashkisë Peqin, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Nga anëtarët, nga kolegët ka pyetje? Po, zoti Braho!

Z. L. Braho: Kam pyetje për administratën. Dakord me të gjithë procedurën e ndjekur, po thjesht për të kuptuar pak këtë tejkalimin nga numri 11, tek numri 13 gjithmonë në interpretim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor. Këtë dua të kuptoj, sepse dhe vendimi nuk ka ndonjë arësyetim se pse nuk ka vijuar me rradhën, por ka vijuar me një kandidat më poshtë në listë.

Znj. P. Doçaj: Partia Socialiste e Shqipërisë në Bashkinë Peqin, ka fituar 9 mandate. Në listën shumemërore kanë qenë një mashkull një femër. Janë katër meshkuj dhe pesë femra të zgjedhur fillimisht. Ikën Anxhela Tabaku dhe në listën shumemërore një femër zëvendësohet me një femër, në referim të nenit 164, pika 2. Nëse doni, e citoj dhe nenin. Kjo dhe për shkak të praktikës, por dhe në referim të Kodit Zgjedhor, një femër zëvendësohet gjithmonë me një femër.

Z. E. Çefa: Nuk është ashtu, jo domosdoshmërisht!

Znj. P. Doçaj: Po, ju lexoj nenin 164, pika 2. “Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës shumemërore së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, përveçse kur plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar. Në këtë rast plotësimi i vakancës bëhet nga kandidati i parë në listë i gjinisë së nënpërfaqësuar pavarësisht renditjes në listë”. Kemi proceduar me lajmërimin, në referim dhe interpretim të kësaj pike...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. L. Braho: Unë dua të kuptoj konceptin e nënpërfaqësimit. Ju thatë që ishin pesë femra dhe katër meshkuj.

Znj. P. Doçaj: Ashtu siç është konfigurimi fillestar i fituesve, ashtu kemi proceduar.

Z. L. Braho: Kush është gjinia e nënpërfaqësuar në këtë rast?

Znj. P. Doçaj: Fituesit kanë qenë nëntë mandate, nga këta katër kanë qenë meshkuj dhe pesë femra. Ne kemi vazhduar me konfigurimin fillestar të fituesve. Kemi zëvendësuar një femër me një femër. Kemi proceduar me Pranvera Karaj që është në listën shumemërore nr. 11, ka refuzuar depozitimin e formularit të dekriminalizimit në referim të nenit 5 të Ligjit 138/2015, i cili na thotë se në rast se nuk depoziton formularin, konsiderohet që ka refuzuar marrjen e këtij mandati. Kemi proceduar brenda afateve ligjore me komunikimin e anëtarit të rradhës që është Donika Karina.

Z. L. Braho: Zotëria, i sati ka qenë në listë?

Znj. P. Doçaj: Zotëria është i dhjeti në listë.

Z. L. Braho: Pra, ju keni kaluar nga 9 tek 11 dhe pastaj nga 11 tek 13?

Znj. P. Doçaj: Po! Kemi vazhduar me vijimin e femrave.

Z. L. Braho: Këtë dua të kuptoj, cili është koncepti i gjinisë së nënpërfaqësuar?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Znj. P. Doçaj: Në rast se do të largohet Bujari që është i katërti, i kalon zotërisë që është Astriti. Pra, do të zëvendësohet me këtë zotërinë. Një femër zëvendësohet me një femër. Kjo ka qenë procedura e deritanishme dhe në interpretim të kësaj pike, gjinia e nënpërfaqësuar janë femrat.

Z. L. Braho: Si? Kur janë pesë femra dhe katër meshkuj, gjinia e nënpërfaqësuar është femra?

Znj. P. Doçaj: Po! Kemi ndjekur konfigurimin fillestar të fituesve.

Z. L. Braho: Dakord, dakord! Po të ishte kështu e kishte shkruar kodi kështu!


Znj. P. Doçaj: Kështu është interpretuar pika 2 dhe kështu është bërë gjithmonë zëvendësimi i vakancave.

Z. L. Braho: Jam shumë dakord, por interpretim nuk ka në vendim. Unë tani po e dëgjoj për herë të parë interpretimin.

Znj. P. Doçaj: Kemi ndjekur edhe dispozitat e Kodit kur normalisht duhet të jenë të barabartë zgjedhja e femrave dhe meshkujve, kemi ndjekur konfigurimin fillestar të fituesve. Fakti që zoti Astrit është kaluar nuk do të thotë që në rastin që do të ikë një mashkull do të zëvendësohet me vijuesin. Pra, do të zëvendësohet patjetër me zotin Astrit.

Z. E. Çefa: Unë kisha diçka, si e lexoj unë. Përpara se ju të konkludoni në këtë formulën që ikën një femër dhe duhet të zëvendësohet me një femër, ju duhet të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

vlerësoni nëse në kuptim të ligjit a ka barazi ligjore në këshill, apo nuk ka? Pra, ka gjini të nënpërfaqësuar, apo jo është rasti? Ligji referon 30 përqindëshin. Në qoftë se numri i anëtarëve të gjinisë së përfaqësuar është nën 30 % atëherë jemi përpara mosrespektimit të barazisë gjinore. Në këtë rast nuk thotë...

Znj. P. Doçaj: Këta janë anëtarë të këshillit bashkiak, ndërsa 30 % është për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Në rast se ne do të shohim pikën vijuese, se si është ky rregull, rregulli është 1:1. Një femër, një mashkull. Në rast se unë do të zgjidhja zotin Astrit do të ulja gjininë e nënpërfaqësuar do të bëheshin 5 meshkuj dhe 4 femra. Ulet gjinia, apo jo?


Z. E. Çefa: Shiko, ju e quani të mirëqenë nënpërfaqësimin gjinor, ndërkohë që aty nuk ka mosbarazi gjinore.

Znj. P. Doçaj: Do të ulja barazinë gjinore në rast se do të zgjidhja zotin Astrit dhe do të bëheshin 5 meshkuj dhe 4 femra.

Z. E. Çefa: Pse? Pra, duhet me patjetër të jenë 50 me 50? Në asnjë mënyrë nuk është kështu.

Z. K. Bele: Po në situatën që zoti Astrit do ta refuzonte? Supozojmë situatën që ju vazhdoni, sepse balanca aktuale, pavarësisht se kush do të vijë... pra, kemi një situatë sot, një fotografim që janë 5 me 4. Pesë gjinia femërorë dhe katër gjinia mashkullore. Në këtë fotografim gjinia më pak e përfaqësuar është gjinia mashkull. Tani krijohet një vakancë, apo jo? Pasi u krijua vakanca kemi këtë fotografim. Nëse ju ja ofroni zotërisë, ai e refuzon, kush do ta zëvendësonte këtë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Znj. P. Doçaj: Në rast se do t'i kalonte zotit Astrit në rradhë është Pranvera, sepse zëvendësohet me të rradhës në rast se është burrë dhe zëvendësohet me një femër, në rast se është një femër. Do të ulte gjininë e nënpërfaqësuar në këtë rast...

Z. K. Bele: Pse e merrni të mirëqenë se është gjini e nënpërfaqësuar kur është 5 me 4? Unë këtë nuk po e kuptoj!

Znj. P. Doçaj: Se do të ishte gjini e nënpërfaqësuar në këtë rast, se do të bëheshin 5 burra dhe 4 gra.

Z. K. Bele: Ju merrni të mirëqenë rezultatin, ju nuk e dini se çfarë do të ndodhë më pas.


Znj. P. Doçaj: Është konfigurimi aktual i fituesve, pesë femra, katër meshkuj. Në rast se unë do të zgjidhja një mashkull do të bëheshin 5 meshkuj, katër femra dhe do të ulej gjinia e nënpërfaqësuar.

Z. K. Bele: 4.5 me 4.5 kjo nuk ndahet.

Z. E. Çefa: 4.5 në kuptim të ligjit konsiderohet barazi gjinore.

Znj. P. Doçaj: Dakord! Ne kështu e kemi interpretuar dhe në referim të ...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. I. Rusmali: Arësyetimin ju lutem, pse femrat në Shqipëri janë gjini e nënpërfaqësuar? Kush ua jep ju autoritetin që të konstatoni që në Shqipëri, në bashki, ose në këshillin bashkiak, femrat janë gjini e nënpërfaqësuar? Nga e nxirrni këtë?

Znj. P. Doçaj: Gjininë e nënpërfaqësuar e kemi pikërisht për faktin se do të bëheshin 5 meshkuj dhe 4 femra. Nënpërfaqësimit konsiderojmë femrën në këtë rast se janë 4 dhe zëvendësimin e vakancës së një femre e kemi bërë gjithmonë me një femër. Një mashkull në rast se largohet e zëvendësojmë me të rradhës. Kjo në interpretim të pikës 2, të nenit 164.

Z. I. Rusmali: Në rastin e gjinisë së nënpërfaqësuar duhet të ruajmë raportin gjinor, po pse në Peqin, janë femrat gjini e nënpërfaqësuar, këtë na shpjegoni?


Znj. P. Doçaj: Jo vetëm në Peqin, në të gjithë... atë po thojta. Në praktikën në qoftë se doni ju sjellim edhe raste të ngjashme se bëjmë përditë zëvendësime vakancash, procedojmë në të tillë formë. E para, ruajmë konfigurimin fillestar të fituesit, pra në rast se fitojnë pesë femra, vazhdojnë të qëndrojnë pesë femra. Pra, siç fitohet fillimisht, atë që ka zgjedhur votuesi dhe më pas...

Z. I. Rusmali: Dakord! Vazhdojnë të qëndrojnë se janë gjini e përfaqësuar jo se janë gjini e nënpërfaqësuar, jo se janë femra, janë gjini e nënpërfaqësuar.

Znj. P. Doçaj: Po!

Z. I. Rusmali: Pse femrat janë gjini e nënpërfaqësuar dhe nuk janë meshkujt gjini e nënpërfaqësuar?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Znj. P. Doçaj: Në këtë rast ne kemi, siç po e thoja kemi zbatuar pikërisht nenin dhe e kemi interpretuar në këtë formë. Në rast se do të zgjidhej një mashkull do të ulej gjinia e femrës dhe nënperfaqësim quaj pikërisht këtë.

Z. I. Rusmali: Pa u zgjedhur një mashkull, raporti është pesë femra, katër meshkuj. Pse nuk janë meshkujt gjinia e nënperfaqësuar në këtë raport?

Znj. P. Doçaj: Aktualisht janë ata gjinia e nënperfaqësuar. Në rast se do të zgjidhja zotin Astrit do bëja gjini të nënperfaqësuar femrat.


Z. I. Rusmali: Ishin pesë femra, katër meshkuj, iku një femër, u bënë katër femra, katër meshkuj...

Znj. P. Doçaj: Jo u bënë katër femra, pesë meshkuj nëse do t'i jepej zotit Astrit.

Z. I. Rusmali: Jo iku, nuk ka ardhur ende. U bënë 4 me 4, kush është kriteri që ua ndan ju? Se kur janë femra më shumë, janë më shumë femra, kur ikën një nga femrat bëhen barazim. Kush është i nënperfaqësuar, ku e merrni ju, ku e caktoni ju vizën për të parë nënperfaqësimin?

Znj. P. Doçaj: Kemi të rradhës, ideja është që kemi të rradhës. Në rast se i rradhës më ul nënperfaqësimin... Po pikërisht 9 mandate si ti ndajmë? 4.5 me 4.5? Do të ulim nënperfaqësimin e njërit, dhe ruajmë konfigurimin fillestar. Atë që kanë fituar fillimisht.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. K. Bele: Pra nëse unë e kuptoj drejtë, më fal. Pra, ne kemi 61 bashki, sipas ligjit numri është gjithmonë tek, apo jo?

Znj. P. Doçaj: I anëtarëve të këshillit bashkiak?

Z. K. Bele: Po.

Znj. P. Doçaj: Janë çift, me një vendim të Komisionerit janë përcaktuar, që të gjitha listat shumemërore do të mbarojnë çift, prandaj janë zgjedhur një femër një mashkull. Po të shohësh listën shumemërore të Peqinit kemi një femër një mashkull në...

Z. K. Bele: Tipikisht në këshillin bashkiak ka anëtarë numër tek apo e kam gabim


Znj. P. Doçaj: Janë tek, fillimisht e cakton...

Z. K. Bele: Abstrakojmë, këshillat bashkiakë Tirana, Fieri, Lushnje a janë tek?

Znj. P. Doçaj: Duhet të jenë tek. Ne kemi marrë një vendim dhe i kemi bërë çift. Vendimi i Komisionerit ka qenë që caktohet ai numri fillestar që të sjell qarku, se normalisht e vendos Prefekti në bazë të popullsisë që ka. Pra, kanë qenë në Peqin 21, po të shohësh listën shumemërore është me 22 kandidatë.

Z. K. Bele: Nuk po flas për listën, flas për këshilltarët aktualë. Pra, numri i këshilltarëve aktualë që prodhohet në fund të zgjedhjeve, është si rregull numër tek? Nëse unë nuk e kam gabim?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Znj. P. Doçaj: Jo detyrimisht. Ata mund të kishin fituar edhe 10 dhe të ishin 5 me 5.

Z. K. Bele: Jo po flas për këshillin bashkiak?

Znj. P. Doçaj: Këshilli bashkiak është me 21 persona.

Z. K. Bele: Në Tiranë është me 61. Në një qytet tjetër është me 31.


Znj. P. Doçaj: Pra, Peqini është me 21.

Z. K. Bele: Pra është gjithmonë me numër tek numri i këshillit bashkiak.

Znj. P. Doçaj: Po. Normalisht e ka për shkak të kourumit se nuk mund të dalin barazim.

Z. K. Bele: Nëse interpretojmë këtë logjikë mund të mos prodhojmë gjithmonë që numri i këshilltareve femra të jetë gjithmonë më i lartë se numri i këshilltarëve meshkuj, sepse si rregull është statistikisht në shkallë vendi. Pyetje kam unë. Kjo mund të jetë hamendësim dhe mbase nuk e kam të qartë. Pra nëse gjithmonë si në këtë situatë, në situata të ngjashme do të pretendohej 5 me 4, apo do të ruhej statusi sipas prezantimit fillestar, i bie që në shkallë vendi, se unë nuk e di se ndoshta për statistikë e nxjerrim, se nuk është e vështirë ta nxjerrim këtë gjë. I bie që në shkallë vendi ne të kemi më shumë këshilltare bashkiake femra se meshkuj, se po vazhdoj pyetjen e zotit Rusmalit. Përsëri ne ecim me prezumimin logjik që gjinia e nënpërfaqësuar është femra. Mund ta kem unë gabim, mbetet për ta parë se këto janë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

gjëra që ne mund t'i verifikojmë dhe në fazat e mëvonshme. Por thashë se mos kishit ju këtë lloj fotografimi, pak a shumë.

Znj. P. Doçaj: Jo nuk kemi një statistikë, ne përgjithësisht i qëndrojmë konfigurimit fillestar. Kryesisht! Pra, një vakancë është ajo, pavarësisht se ne lajmërojmë gratë në rradhë, një vakancë është. Ajo vakancë e krijuar nga Anxhela, që ka vazhduar te Pranvera, që do të vazhdojë te Donika. Një vakancë është ajo. Nuk vendosen 10 gra aty, një është. Ato zëvendësojnë njëra-tjetrën.

Z. K. Bele: Mund të ishte 4 femra dhe 5 meshkuj në konfigurimin fillestar?


Znj. P. Doçaj: Konfigurimi fillestar është 5 femra dhe 4 meshkuj.

Z. K. Bele: Mund të ishte 5 meshkuj dhe 4 femra?

Znj. P. Doçaj: Mund të ishte në rast se do të ishte zgjedhur mashkull i parë në listën shumëmbrore. Partia ka vendosur femrën të parën. Ka vendosur femrën të parën dhe...Vendos subjekti zgjedhor. Për ne mjafton që të ruhet balanca gjinore, që të jetë një mashkull një femër. Në varësi të konfigurimit fillestar kanë fituar 5 femra dhe 4 meshkuj. Kemi ruajtur këtë konfigurim, nuk mund të bëjmë 5 meshkuj dhe 4 femra. Për shkak se na ulet gjinia e nënpërfaqësuar. Në interpretim të nenit 164, pika 2. Siç është interpretuar nga ne. Më pas ndoshta mund të jetë dhe i gabuar, por... Praktika e do që...

Z. K. Bele: Siç e kuptoj unë, për ju gjithmonë gjinia e nënpërfaqësuar është femra, se me këtë supozim logjik ecim se kështu ka qenë në fakt dhe ligjvënësi kur e ka

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

rregulluar para “x” vitesh ketë punë, para 10 a 15 vjetësh ka pasur qëllim... Është e drejtë ajo që thoni ju, ka pasur qëllim të sigurojë barazim gjinor, e sidomos në këshillat bashkiakë, ku tipikisht nuk kishte këshilltare femra. Edhe në Kuvend duke bërë si formulën e përfaqësimit 1:3, si formulën e korektimit gjinor. Ky është qëllimi i ligjvënësit në atë kohë dhe është e drejtë. Problemi është se kanë kaluar vite dhe ne sot kemi një realitet sot që i kemi të barabarte meshkuj dhe femra dhe nuk flasim dot më për gjini të nënpërfaqësuar në këshillat bashkiakë. Sepse ligji vetë nuk lejon mundësi të krijosh nënpërfaqësim. Pra, nëse në Kuvend ti ke një situatë ku ke me ligjin e mëparshëm kishe një mekanizëm korrektues, tani ke përsëri garantimin e 1/3, këtu ti që në momentin e parë që ti e krijon këshillin bashkiak nuk ka nënpërfaqësim, sepse e ka rregulluar ligji të tillë. Nuk prodhon dot lista e këshillit bashkiak nënpërfaqësim, në ndryshim nga Kuvendi në atë situatë që tregova. Që do të thotë ne vim te fotografimi aktual. Pra, ti nuk mund të heqësh një femër dhe të vesh një mashkull kur femrat janë 4 dhe meshkujt janë 5. Pavarësisht ti nuk e bën dot 6 me 3. Unë nuk e kuptoj dot pse 5 me 4 është gjithmonë sipas konceptit tuaj, femra e nënpërfaqësuar edhe këtu. Apo e kam gabim?

Znj. P. Doçaj: Janë 5 me 4 pikërisht për këtë pra, se i pari është femër dhe nëse do fillonte me mashkull do të ishin e kundërta. Pra, lista shumemërore të fillon me femër mund të fillojë edhe me mashkull. Po të ishte raporti 9 fitues, 9 mandate i ndarë 5 meshkuj dhe 4 femra, do të ruanim pikërisht të njejtin konfigurim. Në këtë rast kemi më shumë femra dhe nuk mund t’ia ulim gjininë e nënpërfaqësuar duke zgjedhur...

Z. K. Bele: Po të largohej mashkull në atë situatë, do të zëvendësohej me mashkull?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Znj. P. Doçaj: Nëse do të iki një mashkull aktualisht, do të zevendësohet me mashkullin e rradhës që është zoti Astrit. Për të qenë 4, nuk mund t'ia ulim gjininë.

Z. K. Bele: Po të largohej mashkulli i pestë do të zëvendësohej me mashkull apo me femër?

Znj. P. Doçaj: Nëse do të ishte i fundit i listës?

Z. K. Bele: Me çfarë do të zëvendësohej?

Znj. P. Doçaj: Me të rradhës.

Z. K. Bele: Pra, do të ruhet 5 me 4?

Znj. P. Doçaj: Po do të ruajmë patjetër gjininë, sepse fillimisht dhe nëse do të lexonim interpretimin e ligjit thotë që duhet të jetë 1 me 1 raporti, 50 përqind jo 30 përqind siç është në Kuvend.

Z. K. Bele: Pra, mashkulli zevendësohet gjithmonë me mashkull, femra me femër.

Znj. P. Doçaj: Ne në rastin kur ikën një femër nuk mund të vendosim të rradhës që është një mashkull.

Z. I. Rusmali: Vendimtar për analizën është analiza e konceptit, gjinia e nënpërfaqësuar dhe analizën e konceptit e jep neni i përkufizimeve, i cili e lidh gjininë e nënpërfaqësuar me traditën historike të pushtetit në Shqipëri. Pra, nuk ka

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

lidhje me përbërjen e këshillit bashkiak aktual të Peqinit. Në përgjithësi nuk ka lidhje me përbërjen e këshillit bashkiak të një bashkie të caktuar. Ka lidhje me traditën politike të vendit. Sa kohë që në Shqipëri pjesëmarrja e grave në politikë do të jetë e lidhur me stimulimin e kësaj pjesëmarrje, mekanizma ligjor stimulimi, gratë janë gjini e nënpërfaqësuar në politikë, në organet përfaqësuese. Është përkufizim që e jep kodi, janë gjithmonë kështu deri kur tradicionalisht përfaqësimi i grave të jetë i barabartë, vetë ju, pa mekanizma nxitës shtetëror, ose gratë marrin në dorë pushtetin dhe se lëshojnë më. Burrat do të bëhen dikur pakicë politike në këtë vend dhe do të kërkojnë të drejtat e tyre si minorancë. Nuk jemi në këtë stad historik në Shqipëri, të zhvillimit shoqëror politik në Shqipëri dhe sa kohë nuk jemi në këtë stad gratë me Kod Zgjedhor janë gjini e nënpërfaqësuar. Ky është arsytimi pse. Sa i takon zbatimit që ju na thoni këtu ndoshta duhet që... na takon ne që ta sqarojmë vendimarrjen tonë. Privilegji është vetëm për gjininë e nënpërfaqësuar. Parimi është që zëvendësimi bëhet nga kandidati i rradhës në listë, përveçse kur duhet zëvendësohet kategoria e gjinisë, pra kur ikën një grua duhet të vijë një grua, këtë thotë Kodi. Kur ikën një burrë do të vijë i rradhës në listë, pra jo një burrë. Nuk janë të ndara, burrat zëvendësojnë burrat dhe gratë zëvendësojnë gratë. Vetëm në rastet që ikën një grua duhet të vijë një grua. Në rastet kur ikën një burrë do të vijë kush ka rradhën, mund të jetë grua, mund të jetë burrë, nuk ka rëndësi, por zbatohet parimi i rradhës. Kjo është analiza që duhet të ishte në vendimin e Komisionerit, e para, përpara se të jepeshin të gjitha shpjegimet për procedurën, për dokumentat për formularët, për pranimet, për refuzimet e me rradhë. Duhet të vinte arsytimi pse po zbatohet kriteri i gjinisë së nënpërfaqësuar dhe jo kriteri bazë që është kriteri rradhës. Sikur të ishte ky shpjegim në vendim me siguri dhe ankuesi do të kishte të qartë, të paktën analizën ligjore të gjësë. Sot ankuesi dhe ne ishim të paqartë për analizën ligjore, se analiza ligjore mungon në arsytim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. E. Çefa: Një pyetje tjetër tani se debati po bëhet interesant. Nuk e di, a e ka pasur Komisioneri në konsideratë Ligjin 9970 “Për barazinë gjinore në Shqipëri”, kur ka marrë këtë vendim? Pra, neni 15 thotë përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike, pra siç është rasti jonë, arrihet kur, pra konsiderohet e barazuar gjinia, kur sigurohet përfshirja mbi 30 përqind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore. Që domethënë në kuptim të këtij ligji, në Këshillin e Bashkisë Peqin kemi barazi gjinore, edhe po të jenë 5 burra dhe 4 gra, madje ndoshta edhe po të jenë 6 burra dhe 3 gra, konsiderohen gjini të barabarta. Nuk janë të nënpërfaqësuar, që domethënë në referim të nenit, siç e shoh unë, të paragrafit 2 të nenit 164, nuk aplikohet formula për të plotësuar gjininë e nënpërfaqësuar sepse nuk ka nënpërfaqësim. Ka barazi gjinore dhe për sa kohë ka barazi gjinore ti merr numrin e rradhës në listën e kandidatëve. A e keni pasur këtë në konsideratë në vendimin e Komisionerit? E keni shqyrtur këtë tezë?

Znj. P. Doçaj: Jo, nuk e kemi pasur, sepse ne kemi zbatuar Kodin Zgjedhor. Në bazë të Kodit Zgjedhor ajo që thoni ju bie ndesh me Kodin Zgjedhor.

Z. E. Çefa: Pse bie ndesh?

Znj. P. Doçaj: Kodi Zgjedhor thotë që duhet të jetë lista shumemërore..., që në krye të herës që kur propozohet lista shumemërore ...

Z. E. Çefa: Mos ngatërroni konceptin e listës shumemërore me këshillin! Janë dy gjëra të ndryshme.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Znj. P. Doçaj: Anëtarët e Këshillit Bashkiak përbëhen nga lista shumemërore të propozuara nga subjektet zgjedhore përkatës. Në këtë rast përbëhet nga 9 anëtarë të Partisë Socialiste, e me rradhë të subjekteve të tjera zgjedhore. Ky subjekt zgjedhor ka fituar 9 mandate dhe në referim të këtij Kodi Zgjedhor, ne e kemi përmbushur ashtu sikundër tha dhe zoti Rusmali, e kemi përmbushur duke respektuar nenin 164, pika 2 dhe kemi zëvendësuar një femër me një femër, për të respektuar pikërisht këtë barazi gjinore të cilën e ka përcaktuar Kodi. Në rast se bien ndesh këto dy ligje atëhere nuk është organi...

Z. E. Çefa: Nuk bien ndesh, janë komplementar...

Znj. P. Doçaj: Po pra, se 30 përqind anëtarë të këshillit bashkiak nuk ka, këtu jemi me barazi gjinore, 50 me 50. Se kështu është propozuar që në fillim.

Z. I. Rusmali: Cila është përbërja e këshillit sot nga pikëpamja gjinore?


Znj. P. Doçaj: I gjithë këshilli?

Z. I. Rusmali: Po, i gjithë!

Znj. P. Doçaj: Nuk e kam këtë informacion. Kam informacion vetëm në lidhje me subjektin zgjedhor Partia Socialiste. Nëse doni e nxjerrim, patjetër, por nuk është objekt i këtij gjykimi.

Z. E. Çefa: Mbase e di ankuesi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. I. Rusmali: Për arsyetimin e relatorit ka rëndësi kjo e dhënë.

Znj. P. Doçaj: Këtë të dhënë ne nuk e marrim në asnjë rast. Ne nuk është se i kërkojmë këshillit bashkiak informacion sa meshkuj sa femra keni? Është një gjë që u përket atyre. Pra, në rast se ata do të gjejnë, do të konstatojnë...

Z. K. Bele: Duam ta dimë ne, se kemi ne, kuriozitetin tonë dhe na duhet ta kemi. Ju keni vlerësuar ashtu, nuk po...

Znj. P. Doçaj: E vlerëson këshilli bashkiak në rast se ka psh babai, vajza, burri, gruaja, janë ata që i verifikojnë këto gjëra. Ne zevendësojmë vetëm vakancat.

Z. K. Bele: Ligji nuk është matematikë. Merret dhe lexohet në mënyra të ndryshme.

Znj. P. Doçaj: Nëse ata do të konstatojnë një shkelje të tillë, ndoshta do të procedonin ata...

Z. K. Bele: Jam dakord, por ne në analizën ligjore mund të arrijmë në rrugë të ndryshme.

Znj. P. Doçaj: Patjetër.

Z. K. Bele: Është njësoj sikur të duam të ikim në Durrës dhe dikush zgjedh ti bie nga Ndroqi se mendon që ka më pak trafik edhe pse ka gropa, dikush i bie nga autostrada. Rëndësi ka destinacioni që ne të zbatojmë ligjin. Pastaj arsyetimi duke parë përtej Kodit Zgjedhor apo duke parë një vendim të Strasburgut ne nuk gabojmë. As ju nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

keni gabuar. E keni lexuar ashtu, as ne nuk po gabojmë që po e kërkojmë. Thjesht që ne na duhet dhe kjo e dhënë, që kështu ju lutem dikush nga ju e nxjerr këtë të dhënë dhe vazhdon diskutimi.

Znj. P. Doçaj: Ideja është që duhet ti drejtohem këshillit bashkiak në lidhje me këtë.

Z. K. Bele: Besoj se kjo është publike, duhet të jetë...

Z. E. Çefa: Zoti Astrit, sa është përbërja e këshillit, sa anëtarë ka Këshilli i Bashkisë Peqin, keni informacion? Sa anëtarë ka gjithsej?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: 21!

Z. E. Çefa: Nëse e ke informacionin, do ta verifikojmë gjithësesi, sa janë gra dhe sa janë burra në këtë këshill?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Meqenëse fillon e para femër, atëherë i bie 11 me 10. Femër është dhe kryetaria e këshillit që është zgjedhur. Po t'i marrësh me rradhë femër-mashkull del 11 femra dhe 10 femra.

Z. E. Çefa: Në total?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Po!

Z. E. Çefa: Ky është prezumimi juaj se nuk e keni 100% të saktë, do ta verifikojmë ne. Dakord! Diçka tjetër kishit për të thënë tani se do ta mbyllim

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

përfundimisht. Ne po e mbylлим hetimin tonë këtu, dolën problemet. Tani shkurtimisht na thuaj përfundimisht se çfarë kërkon?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Unë ju thashë që nuk jam jurist. Një shok më tha neni 6 “Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë”. “Çdo trajtim më pak i favorshëm..,” nuk po them për femra për meshkuj, por për shkak të gjinisë, “... çdo trajtim më pak i favorshëm të një personi për shkak të gjinisë në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë, ose do i bëhet një personi të gjinisë tjetër në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë”. Para 5 vjetësh, bashkia tjetër që u zgjodh, më tha që “je ndër të parët në listë”. Kur PD-ja të gjithë u tërhoqën atëherë të 21 socialistët hynë aty. Kur më thërret kryetari më tha, “Astrit kemi bërë një gafë”. Çfarë gafe? Pra, është në vazhdimësi dhe kjo e tanishmja. Çfarë gafe, e pyeta? “Harruam emrin tënd”. Emrin tim që e njeh gjithë Peqini, ju më keni bërë këtë punë? I përplasa derën dhe e lashë atë punë. Ky ishte dhëndri i këtij fisit, që është sivjet kryetar bashkie. Edhe ky veproi kështu. Po të mos jetë asnjë do të zgjidhem anëtar këshilli ...Ika përplasa derën, po nuk të vjen turp i thashë... tani e kam bërë vetëm për këtë... Mustafa Gjinishi është djalë halle me babën tim, prandaj dua të shkoj në Ambasadën Angleze dhe të bëj diçka për Peqinin se flenë gjumë ata. Pa i dhënë një emër shkolle, unë do të plas. Kanë vënë lloj lloj emrash, Mustafa Ataturku, gjimnazi i Pajovës...

Z. K. Bele: Këto hollësitë nuk na duhen ne.

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Më falni, janë nga pasioni.

Z. E. Çefa: Atëherë zoti Kaziu ju përfundimisht i qëndroni ankimit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Kur erdha më thanë, absolutisht nuk dua të hyj as në kritikë, asgjë kësaj shoqes. Do të vish filan ditë, në 12:30. Po! Erdhi, jo jo e mbaruam këtë punë. Po çfarë pune? E vendosëm. Pra, dhe çuditshmja është se ndonjë andej nga Peqini vjen dhe nërhyn, ndërsa unë po vij fare hapur. Po e them e kam dhe për sedër këtë gjë, se më hoqën vjet, o Astrit po si po ndodh me ty? Më fal edhe diçka. Ju betohem! Në 97 kur u hapën armët u mblodhëm u ndamë ne grupe. Vetëm unë mblodha dy furgona armë, asnjë tjetër. Aq respekt kam me peqinasit dhe peqinasit për mua. Prandaj më vjen plasja, më vjen turp. Unë të hiqem nga lista? Më vjen plasja, më vjen turp, plus kam dhe interes për këtë që ju thashë.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë ju i qëndroni ankimit përfundimisht dhe kërkoni ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe mandati t'ju kalojë ju?

Z. Astrit Kaziu, ankuesi: Po! Pse nuk vijnë ata, se e kanë me hile.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Po. Atëherë konkluzionet përfundimtare.

Znj. P. Doçaj: Meqenëse ju kërkuat informacion në lidhje me anëtarët e këshillit të bashkisë janë në total 21, 13 meshkuj dhe 8 femra, aktualisht.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë në fazën e konkluzioneve përfundimtare, KQZ-ja?

Znj. P. Doçaj: Po rrëzimin e ankesës!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

Z. E. Çefa: Dhe lënien...

Znj. P. Doçaj: Po dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve!

Z. E. Çefa: Atëherë faleminderit! KAS do të mblidhet për 15 minuta, 20 minuta do t'u njoftojmë, që të shpallim vendimin. Me kaq e deklarojmë të ndërprerë seancën.

Rifillon seanca

Ora 12:06

Z. E. Çefa: Atëherë KAS pasi e shqyrtoj çështjen në tërësi vërën se në rastin konkret referuar, pra ligji i aplikueshëm është Kodi Zgjedhor dhe këtij ligji KAS dhe Komisioneri kanë detyrë t'i referohen në çdo rast në përcaktimin e zëvendësimit të mandateve në këshillat bashkiakë. Duke pasur në konsideratë situatën në Këshillin Bashkiak Peqin, ku numri i grave është dukshëm më i vogël se numri i burrave, në kuptim të Kodit gratë do të konsiderohen gjini e nënpërfaqësuar në këshill. Referuar pikës 2, të nenit 164, zëvendësimi i mandateve në çdo rast nuk duhet të cënojë numrin e grave të konsistuar fillimisht në këtë këshill bashkiak. Për këtë arsye dhe anëtari i radhës duhet të jetë, nëse largohet një grua duhet të jetë grua, kjo për të respektuar pikërisht pacënueshmërinë e numrit të kësaj gjinie në këshill. Për këtë arsye dhe për këtë argumentim ne vija të trasha KAS vendosi:

- Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.10.2024*

- Ky vendim është i formës së prerë dhe shpallet sot në Tiranë, më datë 17.10.2024.
- Ndaj këtij vendimi palët e interesuara mund të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë brenda afatit të përcaktuar në ligj.

Me kaq këtë seancë e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 23

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

